Prof. Dr. Vebi Bexheti

KONTRIBUTI I REXHEP VOKËS PËR EDUKIMIN NË DIJET HUMANE DHE FETARE TË EPOKËS SË RILINDJES

Aktiviteti i hoxhë Vokës në lëmin e arsimit dhe të edukimit është i drejtpërdrejtë në kohën kur punonte si mësimdhënës në Medresenë e Tetovës. Kjo veprimtari e gjithanshme e tij u zhvillua më tepër kur rilindësit bënin përpjekje të mëdha politike, kulturore dhe arsimore. Intelektualët atdhetarë dhe personalitete të shquara të Rilindjes Kombëtare si: Naum Veqilharxhi, Sami Frashëri, Naim Frashëri, Pashko Vasa, Mihal Grameno etj., gjithsesi me veprat e tyre ndikuan në formimin e personalitetit të Vokës, sepse ai i njihte ato. Duke qenë njohës dhe adhurues i drejtpërdrejtë i rilindësve dhe veprave të tyre, edhe aktiviteti i tij zhvillohej në drejtim të çështjes kombëtare. Veprimtaria krijuese e tij ndryshoi shumë nga ajo e bejtexhinjve, sepse ai nuk ndoqi modelin e kësaj letërsie, edhe pse shkruante me alfabet arab. Letërsia e bejtexhinjve kaloi nëpër dy faza të zhvillimit të saj, në atë të parën, ku mbisundoi tema që trajtonte problematikën shoqërore, dhe në të dytën, kur ajo letërsi është më tepër me karakter fetar. Rexhep Voka i takon një faze të tretë të kësaj letërsie shqipe, që u shkrua me alfabet turko-arab. Ai jetoi dhe krijoi në kohën kur letërsia e bejtexhinjve ia kishte lëshuar vendin asaj të Rilindjes Kombëtare. Përkushtimi për gjuhën amtare dhe arsimimi i popullit ishin ndër detyrimet kryesore të rilindësve, fusha në të cilat përqendrohet kryesisht edhe Rexhep Voka. Veprimtaria krijuese dhe studimore e Vokës është e gjithanshme. Ajo përfshin botime didaktike fetare, gjuhësore, publicistike dhe mbledhje folklori. Vepra "Elifbaja shqip", e botuar në Stamboll, më 1910, është abetare e hartuar sipas një përpunimi që i bëri alfabeti arab, me disa ndryshime në formë shenjash, e herë- herë duke i ndryshuar tërësisht ato dhe kësisoj ai arriti që këtë alfabet t'ia përshtasë gjuhës shqipe, duke gjetur për çdo tingull shkronjën e veçantë. Një vepër tjetër për mësimet fillestare të fesë islame, e rëndësishme edhe për aspekte të gjuhës shqipe, është, "Arnavutçe mufessal ilmihal", botuar po në Stamboll në vitin 1911.

Vepra më e rëndësishme e tij, përmes së cilës ai shpreh idetë përparimtare, të ngjashme me ato të rilindësve, është ajo me titull, "Mendime". Autori më qartë se në asnjë shkrim tjetër të tij, në këtë vepër shpreh pikëpamjet iluministe, çështjen e gjuhës dhe motivin atdhetar. Kjo vepër, e botuar në Stamboll në vitin 1911, pas dy ribotimesh të pjesshme me alfabet shqip të njohura deri tani, ribotohet në vitin 1991 në Tetovë, me transkriptim në alfabetin shqip, të studiuesit Feti Mediu, nga Myftinia e Bashkësisë Islame. Për fat të keq, kjo vepër aq e rëndësishme, deri vonë ishte e panjohur ose fare pak e njohur për lexuesin shqiptar. Shkaku kryesor për mosnjohjen e kësaj vepre deri vonë, ishte vetë alfabeti me të cilin u shkrua. Me këtë vepër, Rexhep Voka kishte për qëllim t'i nxiste bashkëkombësit që ta njohin veten, ta respektojnë fenë, të shkollohen në gjuhën amtare dhe ta ruajnë identitetin kombëtar. Kjo vepër është edhe dëshmi për interesimin e autorit rreth ngjarjeve të kohës dhe të pozitës së shqiptarëve në pushtetin e Perandorisë Osmane, me theks në shkollimin e tyre në gjuhën amtare. Duke qenë i interesuar për fatin e bashkëkombësve të vet, ai u fut në rrjedhat shoqërore të kohës dhe qëndroi më afër lëvizjes kombëtare. Ai ndjen në shpirtin e vet hallet dhe shqetësimet që lidhen me qëndresën e popullit për identitet kombëtar dhe gjuhën shqipe, të shkruar qoftë edhe me alfabet arab, të cilin e mbronte me aq këmbëngulje.

Libri "Mendime" përfshin këshilla, udhëzime dhe mësime nga autori, të shprehura nëpërmjet prozës poetike, e ndonjëherë nëpërmjet vargëzimit me përkujdesje për t'u ruajtur rima, gjë që dëmton aty-këtu lidhjen organike të tërësisë së veprës. Kjo vepër fillon me një lutje drejtuar Zotit, gjë që praktikohej edhe në veprat e letërsisë së vjetër shqipe, ashtu si edhe te Buzuku, që veprën e vet "Meshari", e fillon me një lutje drejtuar Perëndisë për ta ruajtur popullin shqiptar nga e keqja dhe murtaja. Ndër shumë lutje që ia drejton Zotit, hoxhë Voka lutet që t'i ruajë të varfrit nga të këqijat dhe mëkatet: *"O Zot për madhnijn tande ne të vorfnit të na nëkojsh kuri prej dore mos na lishojsh"*. Në pjesën "Disa fjalë vëllazënve të dashëm shqiptarë**"**, autori u drejtohet shqiptarëve që t'i respektojnë këto mendime. *"U falem me nder e u lutem me vërte qi mendimen ta këndoni mir e mir ta kujtoni për nji koh të gjatënë ment ta keni"* (R. Voka, Mendime, f. 7). Në vargjet me titull "Din e Dije**",** autori shpreh lidhjen e besimit fetar me diturinë. Për Vokën këto dy komponentë janë kriter kryesor për të dy jetët, sepse mungesa e njërit, e humb edhe vlerën e tjetrit. Ai mendon se vetëm me fe dhe me dije, njeriu ka gjallëri dhe e shijon jetën. Me vargjet: "*Njeri din e dije kur të ketë atëherë ka xhallni të vërtet" (R. Voka, Mendime, f. 10)*, Voka mendon ashtu si edhe Naimi, i cili te vjersha "Besojmë**"** thotë:

"Një njeri që njeh vethen e tija
E di ç'është edhe Perëndija"!

Edhe për Vokën besimtari i vërtetë duhet të jetë edhe i ditur, sepse si i tillë do të jetë i pranuar edhe te Zoti. Për Vokën njeriu pa fe dhe pa dije është i vdekur edhe pse duket si i gjallë. Ai nuk i ngjan njeriut, sepse i mungojnë virtytet njerëzore. Voka është i pamëshirshëm ndaj njerëzve të tillë, madje nuk ngurron t'i quajë edhe bagëti, sepse kanë shumë gjëra të përbashkëta me to, përveç pamjes fizike: "*Ni neri xhi zhigon sal si t'haje e të pije e nouk mundohet qi të kapë halle të mira e të mëcoje fe e dije, s'ka të ndamë prej bagëtijëve veç se me hije".(po aty).*

Kapitulli më me interes i veprës është ai që i kushtohet kombit. Në këtë kapitull me nëntitullin "Mëcijm**"**, motivi atdhetar dhe dashuria për gjuhën dhe shkollën shqipe është më i qartë dhe më i drejtpërdrejtë. Rexhep Voka në këtë pjesë shpalos qëndrimin e tij kritik ndaj qeverisë osmane. Jetën e popullit shqiptar nën sundimin e të huajve ai e sheh të padurueshme, por këto përpjekje për çlirim kombëtar, sipas tij, nuk do të kenë sukses, nëse mungojnë dija dhe arsimimi. Populli duhet t'i respektojë dijetarët e vet dhe t'u besojë atyre, sepse për të, asnjë komb nuk do të ecë përpara pa prijësit e tij. Çlirimin kombëtar të shqiptarëve Voka e sheh vetëm nëse ata do të jenë të bashkuar me njëri-tjetrin, përndryshe do të vuajnë nën zgjedhën e të huajve. Për rrugën që çon drejt çlirimit dhe bashkimit kombëtar, hoxhë Voka merr për shembull grekët, bullgarët dhe popuj të tjerë në Ballkan, të cilët më herët u çliruan nga sundimi osman: *"Grekë e bullgar edhe shumë fara qera se i cijli ndërmjet asht mëçue e me njime asht bashkue me nji dashnoi të madhe të vlume, të shkulme prej fundit zemrës njani qetrin në sy jan tue zhigue" (f. 11)*. Me këtë konstatim është i ngjashëm edhe mendimi i Çajupit në vargjet e poezisë "Baba Tomorri", kur thotë:

"Nga Turqia tërë shpëtuan:
greku, serbia vllau, bullgari
nën zgjedhë mbeti shqiptari".

Voka i cilëson shqiptarët, si popull ndër më të vjetrit në Ballkan, me njerëz që janë trima, të mençur, të kujdesshëm dhe me shumë cilësi të tjera pozitive, prandaj ata nuk meritojnë të gjenden në këtë pozitë aq të palakmueshme. Ai me keqardhje e vë në dukje gjendjen e vështirë të popullit të vet të paarsimuar, që ka mbetur i fundit, dhe si i tillë nuk njihet dhe nuk pranohet nga popujt e tjerë të Ballkanit dhe të Europës. Që në atë kohë kur fati i popullit shqiptar ishte në duart e Fuqive të Mëdha, Rexhep Voka dëshironte integrimin në Europë, synim ky i vazhdueshëm

i shqiptarëve, edhe sot e kësaj dite: "*Sëpo duën me na ngjoft e me na dijt se jemi as farat xhi kemi mbrenda as Evropa" (po aty)*. Edhe poetët e tjerë të Rilindjes me krenari e shikonin të kaluarën e shqiptarëve dhe të brengosur e përjetonin vuajtjen e tyre nën robëri, të përçarë dhe të prapambetur. Naim Frashëri dhe shumë rilindës të tjerë me argumente shkencore dhe historike tregonin se shqiptarët ishin një komb, një fis e një farë, kurse dallimet fetare duheshin trajtuar vetëm si çështje besimi: "*Gjithkush, çdo besim ta respektojë*",-shkruante Naimi, si kusht për arritjen dhe forcimin e unitetit kombëtar. Për kohërat e lavdishme të Shqipërisë, kur ajo ishte zonjë e vërtetë, Pashko Vasa do shprehej:

"Ti mo ke pas ken një Zonjë e randë
që burrat e dheut të quejshin nan".

Ajo ishte një lavdi e një kohe të shkuar, që për rilindësin e madh nuk i ngjante kohës kur jetoi e veproi vetë:

"Por sot Shqypni, pa më thuaj si je?
por si lisi i nalt i rrëzuem për dhe".

Për këtë gjendje të mjerueshme të popullit të vet, Voka akuzon edhe udhëheqësit shqiptarë, sepse ata nuk ditën ta ruajnë krenarinë e dikurshme të Shqipërisë, madje i turpëruan edhe varret e të parëve:

"Ku ini o krenët e Shqypnijs, për Zotin, veten e fikët edhe vorret e emnat të prinve tan të par i koritët"

(po aty, f12).

Në poezinë "Besa besë", Çajupi për ato kohëra të lavdishme shprehet kështu:

"Ku janë vaftet e parë
Që kini dhënë yrnek,
Ku ini o shqiptarë,
Pse s'ndëgjohet një dyfek"?

Shkaktarin kryesor për këtë rrugë të errët prej nga përpiqej të dalë populli shqiptar, Voka e shihte te padituria, që ishte pengesë për një të ardhme të lumtur. Këtë të vërtetë e konstaton edhe Sami Frashëri kur thotë:

"Në ka gjë për të cilën shqiptarët duhet të kujdesen më tepër, ajo pa dyshim është dituria"

(*S. Frashëri, Shqipëria*, f. 64).

Përshkrimi i gjendjes së vështirë, që i bënte Voka shqiptarit, e që e dallonte nga të tjerët në çdo aspekt, përmes fjalive: "*Vesh kimi po nuk ndijm, sy kimi e nuk shohëm, ment kimi e gja nuk dijm" (po aty, f.12),* është i ngjashëm me vargjet e Nolit, te poezia "Anës lumejve":

"Anës dritës i pa parë
Pranë dijes i pa nxënë".

Siç shihet, këta dy teologë të përkatësive të ndryshme fetare që vepruan në rrethana krejt të ndryshme politike, çështjen e interesit kombëtar e shohin nga i njëjti këndvështrim. Për Vokën, ashtu si edhe për shumë rilindës, shpëtimi kombëtar nuk vjen vetëm përmes tytës së pushkës, sepse kishte kaluar ajo kohë:

"Sot dynjaja asht bo qetër sall me pushk me thik nuk po fitohet po po lijpet edhe kalem e këndijm fjalë e mendim" (po aty),

- shprehej ai. Shumë më herët këtë e thoshte Naimi në poezinë "Gjuha jonë":

"Po sot pendë dhe kartë
Na duhet, nukë tjetër".

Për këtë gjendje të vështirë autori akuzon qeverinë turke të sulltan Abdyl Hamitit. Politika asimiluese e kësaj qeverie dhe gjendja e nënshtruar e shqiptarëve, të cilët ishin të ndarë e të përçarë, i kishin zhveshur nga virtytet e larta të tyre, me të cilat ata mburreshin gjatë historisë:

"Na ndau e na përçau na shtini pushkën ndërmet e na vrau"

(po aty, f.12).

Këtë temë të përçarjes dhe urrejtjes vëlla me vëlla, ndër të tjerë rilindës, e prek edhe Çajupi, kur në poezinë "Baba Tomorri", shprehet :

"Na shkretoi, na preu, na griu,
Na çnderoi, dhe gjakun na e piu".

Sundimi i egër i këtij sulltani, nga Rexhep Voka u kuptua ashtu siç ishte kuptuar edhe nga shumë shkrimtarë të tjerë të Rilindjes, të cilët për këtë sulltan shkruajtën më së shumti. Çdo përpjekje për të drejta kombëtare që do të çonte drejt rrugës për çlirimin, dënohej shumë ashpër, prandaj shqiptarët e kishin mbyllur gojën dhe nuk guxonin të nxirrnin zë, sepse pasojat ishin katastrofale për to dhe familjet e tyre:

"...i mbytshin me far e fëmij më çaf i mirshin e i humshin sa shpirta

ka sa qi për ne lijpet t'i kujtojmë e t'i madhnojmë se me kët rrug të miletit i kan mbyt, oxhakët në jetë va kan fijk",-thoshte ndër të tjera Voka dhe shtonte: "Mbas xhith këtyne të ligjave ma nerzija u trembë, e botën e kapi nji drue e madhe, të flasin xha asqish nuk gëzojshin se për pak e për shum fundin e detit e gjejshin"

(po aty, f. 13).

Rexhep Voka, duke parë se sa e vështirë ishte rruga e përpjekjeve për çlirimin kombëtar, shpresën e fundit të shpëtimit e shihte te Zoti i madhërishëm dhe fuqiplotë. Nga dëshira e tij e flaktë për ta parë kombin e vet në rrugë të mbarë, të ngritur dhe të pajisur me dije, edhe pse si myfti, e harron parimin kuranor, ku thuhet se Zoti s'ka për t'ia ndryshuar gjendjen një populli asnjëherë, në qoftë se ai popull vetë nuk ndryshon, edhe pse nga fundi i veprës ai kthehet prapë te parimi i librit të shenjtë, që edhe nëse shpreson te ndihma e Zotit, pikësëpari kërkon që shqiptarët t'i flakin vetë të këqijat dhe armiqësitë. Përveç dashurisë së madhe për përparim e vëllazërim, duhet të shtohet edhe fuqia për të përballuar pengesat, sepse atëherë Zoti është me ne, mendon Voka:

"Vëllaznijn të bekueme e te vërtet
Në mest ta sellëm për jet
Atëhërë fuqija na shtohet e shkon përpjet
Dhe ndijmimi i Zotit me ne bohet e do jet"

(po aty, f.16).

Shpresën për çlirimin e kombit fillimisht ai e shihte në revolucionin e xhonturqve, në premtimet e tyre, se populli shqiptar do t'i ketë të gjitha të drejtat. Ai mendonte se u plotësua dëshira e kahershme e shqiptarëve për çlirimin kombëtar dhe u hap rruga që do të çonte popullin drejt lirisë. Kjo shpresë dhe zhgënjimi se do të hapeshin shumë shpejt shkollat shqipe dhe se shqiptarët nuk do vuajnë më për asgjë, me kohë u kuptua nga disa shkrimtarë rilindës, të cilët madje për këtë premtim bosh të turqve të rinj, shkruajtën edhe vepra letrare, nga të cilat vlejnë të përmenden komeditë e Çajupit. Në një nga pjesën e veprës "Mendime", ku flet për kohën që çeli rrugën për shpëtimin e mëmëdheut, Voka fut edhe një vjershë të shkruar nga Kamber efendi Elbasani, në të cilën autori shpreh lirizmin e kulluar patriotik, kushtuar atdheut dhe kombit. Vargjet e kësaj poezie Rexhep Voka i kishte lexuar një vit më parë dhe i kishin mbetur në kujtesë, sepse edhe ky poet ishte i shqetësuar për brengat e atdheut, ashtu si edhe vetë autori. Kjo mënyrë e botimit të vjershave të autorëve

të tjerë në kuadër të veprës, na kujton Pjetër Bogdanin, që në veprën e vet botoi vjersha të Llukë Bogdanit dhe Llukë Sumës. Ashtu si shumë rilindës, edhe Voka u bën thirrje shqiptarëve që ta ndihmojnë atdheun, të kujdesen për të dhe të mësojnë sa më shumë, se vetëm në këtë mënyrë do të jenë në shërbim të tij. Në disa mendime të hoxhë Vokës, për sa i përket të drejtave të shqiptarëve dhe rrugës deri në pavarësinë e plotë të atdheut, vërehen edhe luhatje. Sipas tij, është mirë t'i shtrihet dora e pajtimit edhe "Dovletit", sepse në atë mënyrë më lehtë mund arrihet shpëtimi, gjallërimi e fitorja:

> *"Mirë me u kujtue, nji dakik me mos vënue po me të tan fuqin e talentin xhi kimi, dovletit e miletit dorën me ja dhanë nji fuqi e një forc të madhe me pru, se shpëtijmi fëtejmi, gjallnijmi... ka me kan"*
>
> (po aty, f.15).

Unitetin dhe mospërçarjen në aspektin fetar e dialektor të shqiptarëve që ishte edhe motoja kryesore e rilindësve, Voka e përkrahu fuqimisht, edhe pse ai ushtroi funksione të larta në pushtetin e Perandorisë Osmane, siç është edhe pozita e tij e lartë si myfti i Vilajetit të Manastirit. Qëndrimi aq i qartë i Vokës lidhur me raportin fe-atdhe, ishte ana më atdhetare e tij. Për fat të keq, vepra e shkurtër, por shumë me interes për kombin "Mendime" e Rexhep Vokës, u injorua nga disa qarqe intelektuale shqiptare, gjithsesi për shkak të përdorimit të alfabetit arabo-turk, nga njëra anë, dhe disa forcave më të theksuara antishqiptare perandorake, për shkak të insistimit të tij për shkollë shqipe dhe qëndrimit të paluhatshëm që kishte për kombin. Mosnjohja për një periudhë aq të gjatë e kësaj vepre dhe e autorit të saj, ishte humbje e madhe edhe për lëvizjen rilindëse, në kohën kur manipulimet qeveritare të kohës dhe keqpërdorimet e fesë, ishin vetëm në interes të Portës së Lartë. Perandoria Osmane me kohë e kishte shpikur propagandën për ta mbrojtur tezën se të gjithë myslimanët i takojnë kombit turk, prandaj qëndrimet e tjera, të bazuara në argumentet e së vërtetës nuk shiheshin me sy të mirë. Mendimet aq të shëndosha të Rexhep Vokës, të bazuara në këtë realitet, edhe pas aq shumë viteve janë të dobishme edhe sot, kur keqpërdorimet në emër të fesë dhe me përmasa ekstremiste, po marrin hov gjithnjë e më tepër, edhe në hapësirat shqiptare. Thënia aq me peshë e Vokës, se feja duhet t'i bashkojë njerëzit e jo t'i përçajë, aq më tepër kur del nga goja e një kleriku mysliman, duhet të shërbejë si mësim, së pari për shqiptarët që u takojnë më tepër besimeve dhe njerëzimit në përgjithësi:

"Ma ta qesëm pri zemre gjallzijn e të kapim mirsijn e mbarsijn, të mo thomi ki musliman e ki i krishten, jo toskë jo gegë se xhith xhi jemi shqiptar jemi nji fis e nji far".

Këto mendime e thënie janë shumë të ngjashme me vargjet e poezisë, "Baba Tomorri", të poetit të madh rilindës, Çajupit, kur thotë:

"Të krishterë e Myslimanë
Gjith një Perëndi kanë,
Ini një gjak more të mjerë
Se ndë një vend kini lerë".

Për Vokën nuk mund të ketë përparim pa arsimim në gjuhën amtare. Ai shprehet se nuk ka shembull në historiqë një komb të edukohet dhe arsimohet në mënyrë të gjithanshme në gjuhë të huaj:

"Teri të këndojm edhe në gjuhën tonë komit dije e terbije të përgjithshme sëmundemi me i dhan. Nuk asht pa në tarihe e në jetë nji milet xhi asht parue e asht naltzue pa këndue në gjuh të vet"

(po aty, f.15).

Për rëndësinë e gjuhës amtare dhe vlerën e saj në historinë e një kombi, ashtu si shumë rilindës tjerë, edhe Naimi shprehet kështu:

"Të shkruajmë gjuhën tonë,
Kombin ta ndriçojmë,
Gjithë ç'është e ka qenë
Nga dalëz ta mësojmë".

Në Kongresin e Dibrës, në vitin 1909, për çështjen e shkollave shqipe dhe nevojën e nxënësve shqiptarë për mësimin në gjuhën amtare, hafës Ali Korça thotë:

"Ndër ata fshatra që s'ndollen shkolla fillore me doemos të çelen dhe ndë gjithë shkollat e Shqipërisë"

(Ismail Ahmeti, Hafiz Ali Korca...f. 25).

Një rilindës tjetër i madh, me dije të gjithanshme dhe njëkohësisht rektori i parë i Universitetit të Stambollit, që me kohë ishte i edukuar në frymën e Rilindjes, Hoxha Tahsini, theksonte se hapi i parë nga duhej filluar lufta për çlirimin e atdheut ishte përhapja e arsimit në gjuhën amtare. Pikëpamjet përparimtare të Rexhep Vokës për mënyrën e predikimit fetar, dalin edhe nga qëndrimet e tij, në përdorimin e gjuhës amtare edhe për

predikimet fetare. Ai thotë se për këtëasnjë dijetar nuk ka mendim tjetër:

> *"Asnji nuk asht da e kan than qi si i cilli kom dije të fes mundet t'i çet në gjuhën e vet"*
>
> (po aty, f.16).

Ky mendimtar, dhe njohës i mirë në dijet humane dhe fetare, thekson se është e nevojshme që krahas dijes së përgjithshme, edhe feja duhet të mësohet në gjuhën amtare, dhe se kjo kërkon bashkëpunim mes dijetarëve dhe imamëve, sepse vetëm ashtu do të kenë më tepër sukses në punën e tyre:

> *"Diku këjo pun do të jet qi dijetarët e imamët të dijnit të tanë me nji jan ba".*

Edhe Josif Bageri i Rekës historike, atdhetari, poeti dhe publicisti, që një jetë ia kushtoi kauzës shqiptare, ashtu si Rexhep Voka, u angazhua për shkollën shqipe, për mësimin në gjuhën amtare dhe tolerancën fetare, dialektore dhe krahinore, se vetëm të bashkuar do mundej armiku më lehtë:

> *"Ejani ta ngjallim kombin, se armiku na përpiu e na gëlltiti,... eni të vllazënohemi dhe të bashkohemi e të punojmë vetëm për kombin, vetëm për gjuhën e bukur amtare dhe për shpëtimin e Shqypnis, shkruante ky rilindës"*
>
> (Ruzhdi Mata, Josif Bageri, f. 33).

Paralelet mes vargjeve e mendimeve të disa rilindësve dhe veprës së Rexhep Vokës, janë një dëshmi për ndihmesën e madhe që ky intelektual i dha çështjes kombëtare, në një periudhë kohore, kur përpjekjet dhe kërkesat e shqiptarëve për liri e pavarësi ishin më afër finales së madhe, që për fat të keq u realizuan vetëm pjesërisht, me shpalljen e Shqipërisë londineze. Kontributi i Rexhep Vokës dhe pjesëmarrja e tij në këto aktivitete, deri vonë mbeti nën hijen e qëndrimit të tij për çështjen e alfabetit dhe përcaktimit për alfabetin arabo-turk, që me disa ndërhyrje teknike ia përshtati gjuhës shqipe. Përkrahja e tij për alfabetin arab, kur shumica e rilindësve ardhmërinë e shkrimit të shqipes e shihnin në alfabetin me bazë latine, e kishte arsyetimin e vet. Në mars të vitit 1910, kur ai i paraqet parisë së Janinës një trajtesë të vogël me të cilën porosit të shkruarit e shqipes me alfabet arab, Klubi i këtij qyteti i dërgoi protestë vezirit të madh dhe ministrit të Arsimit në Stamboll, duke theksuar se

toskët kanë vendosur të mbajnë alfabetin latin. Në një deklaratë të veten, Voka qëndrimin e tij për alfabet arab e arsyeton kështu: "Populli shqiptar shkruan dhe arsimohet në gjuhën e vet, me shkronja arabo-turke, sepse në këtë mënyrë, do kemi më tepër shqiptarë në administratën shtetërore, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër më lehtë do ta hedhim poshtë mendimin e keq që mbretëron midis turqve për ne, se jemi renegatë të Turqisë" (V. Bexheti, Rexhep Voka, f.36). Mendoj se ky hoxhë atdhetar bëri shumë më tepër për kombin se sa mëkatet që po e rëndojnë mbi shpatulla edhe sot e kësaj dite, aq më pak, kur dihet se ky personalitet, për gabimin që bëri është vetëkritik dhe i penduar, gjë që e bëri në mënyrë publike, në gazetën "Shqipeja e Shqypnis", të Sofjes, që e udhëhiqte Josif Bageri. Në një tekst me titull "Pendimi i Myftis së Manastirit", të kësaj gazete, shkruhej:

> *"Javën që shkoi na erdhi një letër prej Kostandinopojës në të cilën na shkruan një mik i afërm i Rexhep Efendiut, i cili përpara shkronjës e ka njohur fajin që bani për shtypjen e Abetarit me shkronja arapçe dhe u pendue, por ka turp të dalë sheshit për me e poshtrue punën e ndytë dhe të mbrojë të drejtën".*

Përfundime:

- Rexhep Voka është ndër ata personalitete, që me veprimtarinë e tyre kanë hyrë në historinë e popullit të vet.
- Ai mbetet një personalitet i shquar fetar që e zgjidhi drejt raportin fe-atdhe.
- Veprimtaria e tij praktike dhe teorike krijuese i shërbeu emancipimit shoqëror dhe përsosjes morale të bashkatdhetarëve të vet.
- Rexhep Voka jetën e vet ia kushtoi arsimimit të bashkëkombasve të tij, i bindur se ata nuk mund të ecin përpara pa zhvillim e arsim në gjuhën amtare.
- E gjithë veprimtaria e Rexhep Vokës synoi edukimin e brezave në shumë aspekte, pa dallime krahinore, fetare, fisnore.
- Voka fillimisht ishte për alfabet arabo-turk, qëndrim ky që nuk u kapërcye aq lehtë, edhe pse asnjëri para tij nuk e vuri re se alfabeti arab nuk ishte i përshtatshën për gjuhën shqipe.
- Me veprimtarinë e tij të gjithanshme, Rexhep Voka ishte në frymën e rilindësve.
- Megjithëse për shkaqe ideologjike, në të kaluarën u bënë përpjekje

për ta lënë nën hije personalitetin dhe veprën e Rexhep Vokës, ato u bënë objekt studimi nga shumë studiues e veprimtarë shkencorë.

Bibliografia

1. Rexhep Voka, "Elifbaja shqip", Stamboll, 1910.
2. Rexhep Voka, "Mendime", Stamboll, 1911.
3. Rexhep Voka, "Mendime, transkriptuar dhe pajisur me shënime, nga Feti Mediu", Tetovë, 1991.
4. Rexhep Voka, "Arnavutçe muffesal ilmihal", Stamboll, 1911.
5. Revista pedagogjike "Shkollës shqipe", Tiranë, 1943.
6. Hasan Kaleshi, "Prilog poznavanja arbanska knjizhevnosti na arbanskom jetiku, Godishnjak, Ballkanoloshki knjiga I", Sarajevo, 1957.
7. Hasan Kaleshi, "Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll", Gjurmime albanologjike, nr.1, Prishtinë, 1970.
8. Musa Kraja, "Mësuesit për kombin shqiptar", Tiranë, 1993.
9. Vebi Bexheti, "Rexhep Voka dhe vepra e tij 1847-1917".
10. Vepra nga rilindësit shqiptarë.